



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 6.11.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Sërgjan Mitroviq, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Salih Salihu dhe Salih Zyba.

Munguan: Etem Arifi dhe Liburn Aliu.

I ftuar: Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës (AMKMK)

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtur më 2 dhe 9.10.2018;
3. Shqyrtimi i gjendjes aktuale të komplekseve memorialë në Kosovë, i ftuar drejtori i AMKMK- së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen nga Zhurma;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtur më 2 dhe 9 tetor 2018;

Muharrem Nitaj, kryetar, konstatoi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtur më 2 dhe 9 tetor 2018.

3. Shqyrtimi i gjendjes aktuale të komplekseve memorialë në Kosovë, i ftuar drejtori i AMKMK- së

Muharrem Nitaj, kryetar, njoftoi se për të diskutuar për gjendjen e Komplekseve Memorialë, i ftuar në mbledhje është drejtori i kësaj Agjencie Z. Bislim Zogaj, të cilin e falënderoi për pjesëmarrje.

Bislim Zogaj, drejtor i AMKMK-së, fillimisht i falënderoi anëtarët e komisionit për besimin e dhënë për drejtor të kësaj Agjencie, pasi që është takimi i parë pas zgjedhjes së tij. Pastaj tha se raporti është i shkurtër dhe e kemi dërguar vonë (një ditë para mbledhjes). Arsyeja është se kemi një staf të vogël dhe ka qenë koha e shkurtër për përgatitjen e tij. Në këtë raport jemi munduar të paraqesim gjendjen reale dhe jam i prirur që të mos merrem shumë me të kaluarën, por me atë që më takon mua. Me gjendjen e Memorialëve dhe Komplekseve memorialë, që janë në kompetencë të agjencisë, nuk jemi të kënaqur askush. Kemi një numër të madh të komplekseve që kanë kaluar në kompetencë të agjencisë dhe që nga themelimi, të gjithë memorialët, shtatoret dhe varrezat, që janë bërë nga paslufta, me baza vullnetare, shpeshherë janë bërë shkel e shko, përveç kësaj ka munguar mirëmbajtja dhe sot kemi shumë memorialë të dëmtuar.

Prej marrjes së detyrës në agjenci, synim i parë imi ka qenë Kompleksi Memorial “Adem Jashari” pastaj të gjitha komplekset e tjera në tërë Kosovën. Për të bërë një punë të mirë, prioritet i yni është që punët që i bëjmë, të jenë të nivelit më të lartë të mundshëm dhe të njëjtën kohë të kemi mirëmbajtje të mirë. Me buxhetin e vitit të ardhshëm e kemi rritë mundësinë që më shumë komplekse ti mirëmbajmë, duke u zgjeruar vit pas viti. Këtu na duhet mbështetja e komunave dhe se ato komuna ku kanë shpreh gatishmëri më të madhe, kemi gjendjen e komplekseve memorialë më të mirë.

Zogaj shtoi se ka shumë probleme me memorialët, duke filluar së pari me Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, ku gjendja e kullave të rezistencës është e rëndë, por pasi që tani është aprovuar Ligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, ne si Agjenci do të angazhohemi maksimalisht që sa më parë të fillojnë punimet në këtë kompleks për t’i shpëtuar objektet e rezistencës pa urrënuar dhe ta bëjmë që ky kompleks të jetë i dinjitetshëm, ashtu siç e meriton.

Probleme ka edhe me memorialë të tjerë. Për Memorialin Ibrahim Rugova në Prishtinë, ka qenë një projekt i hartuar nga MMPH-ja, i cili ka filluar të realizohet dhe në ndërkohë i janë ndërprerë punimet kësaj kompanie nga MMPH-ja. Tani ky Memorial ka kaluar në kompetencën tonë. Kemi vlerësuar se projekti nuk i plotëson kriteret e kohës dhe rrethanave të krijuara në këtë hapësirë (tani përveç varrit të Ibrahim Rugovës, e kemi edhe varrin e Adem Demaçit, Varret e Dëshmorëve) dhe se duhet të bëhet një projekt krejtësisht tjetër. Në këtë projekt do të duhej të përfshihen edhe institucionet tjera si: Komuna e Prishtinës, MMPH-ja, MKRS-ja, Shoqatat e dala nga lufta, banorët e lagjes etj. Problemi në Kompleksin Memorial në Meje – Gjakovë, që ka qenë shumë mediatik dhe është për keqardhje, pse nuk është zgjidh deri tash, por prej se kam marrë mandatin, jam marrë shumë me këtë problem, pasi që kemi pas problem me një firmë, e cila nuk e ka kryer punët me përgjegjësi, dhe ne ika kemi ndërpre punën. Mendoj se deri kah fundi i muajit do ta përfundojmë këtë problem, ndërkohë që ky projekt shtoi ai, ka filluar tash 13 vjet.

Muharrem Nitaj, kryetar, e falënderoi për raportin dhe e vlerësoi si raport të përgjithshëm pa detaje dhe specifika financiare. Përveç Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, do të doja të raportoni për mjetet që janë shpenzuar në total në ndërtimin dhe mbikëqyrjen e memorialëve, por raporti me siguri do të plotësohet me pyetjet dhe përgjigjet në vazhdim.

Bislim Zogaj, tha se raporti kam menduar të jetë vetëm si udhërrëfyes për debat, ndërsa raportin financiar jemi të gatshëm të përgatisim, vetëm kërkojmë pak kohë, për ato projekte të cilat i kemi kryer si agjenci, sepse ne menaxhojmë edhe shumë komplekse memorialë, lapidare dhe varreza që ne si i kemi kryer punët, projektin dhe investimin, sepse për to, ne nuk kemi të dhëna.

Salih Salihu, kërkoi nga drejtori që të kenë gjithmonë raporte të qarta financiare, pasi që është punë shumë e ndjeshme që mos të ndodhë që pasardhësi i juaj në këtë pozitë mos të thotë se nuk dua të merrem me punën e mëhershme. Të kihet kujdes te profesionalizmi në punë, dhe mos të

bëhen punët shkel e shko, projektet të kryhen me kohë dhe mos të vjen deri te zhgënjimi i familjarëve.

Besa Gaxherri, tha se shkas për këtë takim ka qenë vizita dhe njoftimi për së afërmi me gjendjen në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”. Ajo filloi me citimin e pjesës përfundimtare të raportit “*Memorialët e ndërtuar nga përfundimi i luftës e deri para pesë viteve kanë filluar të dëmtohen për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, por edhe për shkak të ndërtimeve jo të qëndrueshme dhe profesionale. Memorialët e ndërtuar në pesë vitet e fundit janë në gjendje shumë më të mirë. Synimi i AMKMK-së është që ne, përveç ndërtimit të projekteve të reja të krijojmë mundësitë që edhe të gjitha Komplekset dhe Memorialët tjerë t’i mirëmbajmë*”. Nuk ka të dhëna financiare në raport, përveç për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, ku thuhet se deri më tani janë investuar mbi 10 milionë euro, dhe ne ishim në vizitë, e kemi pa gjendjen, edhe pse nuk jam profesioniste e inxhinierisë, mendoj se nuk janë harxhuar më shumë se 3-4 milion euro dhe në bazë të kësaj, si komision duhet të kërkojmë të bëhet një auditim për këtë por edhe për secilin memorial tjetër, sepse është e papranueshme të keqpërdoren mjetet e memorialëve. Për shpronësimet e 20 hektarëve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, pyeti kush janë pronarët, pasi që gjatë vizitës, kryetari i Komunës Bekim Jashari, tha se ne nuk jemi të interesuar të përfitojmë nga shpronësimi dhe a ka edhe pronarë të familjeve tjera për shpronësim, përveç familjes Jashari. Në fund, tha se presim një raport më të gjerë me të dhëna financiare dhe dha një porosi për drejtorin për shkëputje nga aspekti politik i të vdekurve dhe dëshmorëve, pa anim dhe me i marrë të gjitha komplekset të barabarta, sepse të gjithë dëshmorët janë të barabartë.

Muharrem Nitaj, kryetar, pyeti drejtorin, sa kohë ju duhet që të përgatisni një raport të detajuar financiar për të gjithë kompleksët memorialë, me informacionet që u përmenden këtu, siç janë: fazat e ndërtimit, mjetet e shpenzuara dhe mjetet që kërkohen për përmbylljen e këtyre projekteve.

Bislim Zogaj, tha se sa i përket vjedhjeve të tilla, nuk ka turp më të madh se ai që shpërdoron mjete të tilla. E dyta, për raportin, kërkoj mirëkuptim, pasi që në dy javët e ardhme janë auditorët në agjenci, dhe mungesa e kohës, pastaj është fundi i vitit dhe janë disa obligime të tjera pasi që përfundojnë disa projekte, si dhe jemi në fund të vitit, kur edhe ne do ta përgatisim raportin vjetor për Kuvend, pra, kërkoj kohë deri në fund të vitit për ta përgatitur këtë raport.

Andin Hoti, duke u dakorduar me pyetjet e parafolësve, pyeti për afatet kohore për projektin e Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, pastaj sa memorialë në përgjithësi janë në Kosovë në menaxhimin e Agjencisë, dhe a është futur në listën e memorialëve të Agjencisë, Shtëpia Muze e Ukshin Hotit. Hoti kërkoj që ti kushtohet vëmendje Kompleksit Memorial të Dëshmorëve të Kombit në Rahovec, pasi që është në gjendje të mjerueshme.

Ganimete Musliu, falënderoi për këtë raport dhe kërkoj të raportohet nga koha kur ka marrë detyrën drejtori, z. Zogaj, cilat projekte i ka gjetur në gjysmë, e cilat i ka përfunduar, në mënyrë tabelore me të dhëna të sakta, ngase raporti për vitin 2017, është votuar në mbledhjen plenare andaj, pse të obligohet i njëjti prapë këtë ta kryej pa pasur obligim, përndryshe për pakënaqësi të ndryshme dhe financiare, ky Kuvend mund të themelojë Komisionin hetimor.

Gjithashtu, ajo u pajtua që mos të bëhen dallime të dëshmorëve, duke potencuar se Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, duhet të gëzojë prioritet.

Musliu pyeti për gjendjen e kullave të familjes Ahmeti në Likoshan, dhe duke e përgëzuar për punën e kryer në kompleksin në Morinë, sugjeroi që komplekset që nuk kanë ciceron, të paktën të kenë një legjendë e shkruar.

Muharrem Nitaj, kryetar, tha se raporti i votuar ka qenë për vitin 2017, kurse tani është nëntori i vitit 2018, prandaj kërkesa për raportim nuk është dyfishuar.

Nitaj shtoi se po kërkojmë një informatë, si e ka gjetur gjendjen në agjenci dhe çfarë ka bërë për këta muaj në detyrë, sa para janë shpenzuar, cilat projekte janë përfunduar dhe sa mjete duhen për përfundimin e këtyre projekteve?

Salih Zyba, tha se ky nuk është raport, por vetëm një informatë dhe insistoi për një raport të paktën pasi që e ka marrë detyrën e drejtorit dhe kërkoi sqarime nga drejtori, duke e cituar drejtorin që tha “*për ato që janë kryer më herët nuk kemi të dhëna*”.

Zyba tha se raporti financiar duhej të ishte i veçantë, edhe pse u përmend te disa memorialë, nuk kemi përfshirje të listës së memorialëve që janë të mbrojtura dhe nuk është asnjë link, ku mund ti gjejmë. Duke përfshirë listën e të gjithë memorialëve, do të del në pah edhe kontributi vetjak i familjarëve dhe i diasporës, që nuk është përmend këtu, ndërsa për “vetëdijesimin e firmave”, tha se ato nuk kanë nevojë të vetëdijesohen, pasi që ato e kanë obligim ligjor për punët e tyre.

Lutfi Zharku, tha se nuk janë përfshi të gjitha varrezat e dëshmorëve, pasi në çdo qytet ka varreza të dëshmorëve dhe pyeti, a keni diskutua në agjenci me u kufizua në mirëmbajtjen e 4 apo 5 komplekse më të mëdha dhe të tjerat me u bartë nëpër komuna, pasi që ju si agjenci e keni të vështirë të kujdeseni për të gjitha, dhe në fund shtoi, se më shumë për varrezat kujdesen familjet sesa institucionet.

Bislim Zogaj, theksoi se momentalisht nuk dihet edhe sa mjete duhen për përfundimin e projekteve të komplekseve, pasi që kemi shumë projekte dhe kërkesa për ndërtime të reja. Kemi projektin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe me ligjin e miratuar, parashihen rreth 21 milionë euro investime, pastaj e kemi projektin tjetër që MMPH-ja e ka shpallë si zonë të veçantë, Malet e Berishës, Kleçkës dhe Divjakës, projekt ky që kushton rreth 22 milionë euro. Vetëm këto dy projekte, kanë kosto të lartë, por llogarisim që edhe përmes donatorëve ta përfundojmë projektin.

Agjencia ka shumë punë dhe nuk na jep komoditet të merremi me të kaluarën se kush i ka bërë punët keq, pasi që me to merret hetuesia, ndërsa e marr përgjegjësinë për punët që janë kryer në mandatin tim, prej datës 12 korrik 2018.

Sa i përket shpronësimit, me ligj është e paraparë që të gjitha pronat që janë në zonë duhet të shpronësohen.

Sa i përket animeve politike, me përgjegjësi të plotë e them se nga momenti i marrjes së mandatit në agjenci, për mu nuk ka dallime partiake e as rajonale sepse të gjithë të rënë i llogaris i pjesë e familjes sime.

Me miratimin e Ligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, ne do ti nxjerrim dy udhëzime administrative, pastaj aty do të formohet një komision nga disa institucione.

Sa i përket projektit të Shtëpisë Muze të Ukshin Hotit, kam diskutuar me kryetarin e Rahovecit dhe për momentin është në mbikëqyrjen e Ministrisë së Kulturës, dhe me ligjin e Agjencisë është e paraparë që të gjitha komplekset memorialë mund të kalojnë në kompetencë të Agjencisë me iniciativë të pushtetit lokal ose qendror. Ne si Agjenci kemi rezervuar kodin me shumë 20 mijë euro, për fillim nëse kalon në kompetencë të agjencisë.

Rreth Projektit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, Agjencia ka pasur një tender, ku është përzgjedh një kompani për konservimin e shtëpive apo objekteve të qëndrësës. Projekti ka kushtuar rreth 6 milion euro.

Kompleksi i kullave të familjes Ahmeti në Likoshan, agjencia e ka bërë konservimin e atyre shtëpive dhe me buxhetin e vitit të ardhshëm do ta mbikëqyrim dhe mirëmbajmë, dhe do të kemi një gjendje edhe më të mirë.

Kemi shumë komplekse që u mungojnë ciceronët dhe kemi kërkua pranimin e së paku edhe 5, por do të shikojmë edhe mundësinë e legjendës.

Ka qenë e pamundur të mirëmbahen 121 komplekse përkujtime me këtë buxhet, për vitin 2018 i kemi pas vetëm 5 komplekse për mirëmbajtje. Me buxhetin e vitit të ardhshëm, i kemi parapa 40 deri në 50 komplekse për mirëmbajtje dhe çdo vit do të rrisim numrin e tyre.

Faqja e Agjencis është e mangët dhe do ta mirëmbajmë më mirë. Ka komuna të cilat kanë shprehur gatishmërinë për mirëmbajtje të memorialëve dhe jemi marrë vesh t'i ndajmë detyrat.

Muharrem Nitaj, kryetar, e falënderoi drejtorin e agjencisë, duke ia rikujtuar se pas tre javësh, komisioni e pret me raportin e kërkuar, duke e dërguar atë disa ditë përpara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen nga Zhurma

Muharrem Nitaj, kryetar, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 06/L-128 për Mbrojtjen nga Zhurma dhe shtoi se ai i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit. Pasi që nuk pati asnjë diskutim, ftoi Komisionin për votim: kryetari konstatoi se komisioni me 5 vota për dhe 1 abstenim, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligjin nr. 06/L-128 për Mbrojtjen nga Zhurma

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës

Muharrem Nitaj, kryetar, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 06/L-127 për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës dhe shtoi se ai i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit. Pasi që nuk pati asnjë diskutim, ftoi komisionin për votim: kryetari konstatoi se komisioni me 5 vota për dhe 1 abstenim, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-127 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës.

6. Të ndryshme.

Muharrem Nitaj, kryetar, njoftoi se në leximin e parë ka kaluar Projektligji nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i hartuar nga komisioni dhe tani duhet të formohet një grup i punës për ta shqyrtuar atë. Kryetari u pajtua të diskutohet kjo çështje edhe njëherë me deputeten Besa Gaxherri, e cila ka qenë kryesuese e grupit të punës për hartimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 12:04

E përgatiti :

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Muharrem Nitaj